




REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRAN

Nr. / Br. 48747/25
Nr. i fq. / Br. st. -2-
Data: / Datum: 12.09.25
VUSHTPRI - VUČITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

DATE/A	12.09.2025
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetarit të Komunës z. Ferit Idrizi
NGA/OD/FROM:	Drejtori i DBZHR-së z. Ergin Sungur
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	THIRRJE PER APLIKIM

Për fermerët e Komunës së Vushtrrisë për përfitim në kuadër të implementimit të projektit: "Subvencionimi i prodhimtarisë së qumështit".

I. Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është njoftimi i të gjithë fermerëve – blegtorëve prodhues të qumështit, të Komunës së Vushtrrisë se Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në kuadër të Programit për Zhvillimin e Bujqësisë do të subvencionojë prodhimtarinë e qumështit për periudhën Korrik-Dhjetor 2024.

II. Mënyra e subvencionimit.

- Subvencionimi do të bëhet për litër të qumështit të dorëzuar në pikë grumbulluese ose në fabrika të përpunimit të qumështit në vlerë prej 0.05€/litër;
- Përfitues do të jenë fermerët prodhues të qumështit sipas standardeve të legjislacionit në fuqi.

III. Kriteret e përcaktuara

- Aplikuesi duhet të jetë banorë i Komunës së Vushtrrisë.
- Të dorëzoj më shumë se 2000(dy mijë) litra qumësht për këtë periudhë 6 muajore.



- Të posedoj kontratë për shitjen e qumështit në ndonjërin nga qumështoret e licencuara ose me ndonjërin nga pikat grumbulluese të qumështit të regjistruara si biznes dhe që kanë kontratë me ndonjë nga qumështoret e licencuara;
- Të ofroj dëshmi për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar) në ndonjërin nga qumështoret e licencuara;
- Të ofroj dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar).

IV. Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. Konfirmimin nga banka për posedim të llogarisë bankare aktive;
3. Vërtetimin nga pika grumbulluese ose qumështorja për sasinë e qumështit të dorëzuar për periudhën Korrik – Dhjetor 2024;
4. Kopja e listës së verifikimit të kafshëve të vitit 2024 lëshuar nga sektori për identifikim dhe regjistrin në kuadër të AUV;
5. Dëshmia e pagesës nga banka për sasinë e qumështit të shitur (dorëzuar)- pasqyra bankare për periudhën Korrik- Dhjetor;
6. Kopja e kontratës, për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara ose pikat grumbulluese të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjë qumështore të licencuar.

Kjo thirrje publike është e hapur për aplikim prej datës: **12.09.2025 – 30.09.2025.**

Aplikacioni dorëzohet në zyrën e pranimit çdo ditë pune.

